



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 426, datë 8.7.2021

P Ë R

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.202, DATË 5.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT
TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN
DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE,
SI DHE ÇDO NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION
TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.202, datë 5.3.2020 , të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2.1, shtohet pika 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.2. Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2021, do të jetë në masën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210

“Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 500 000 000 (pesëqind milionë) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ